



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RREGULLORE Nr. 7, datë 02.10.2018
PËR “PËR PROCEDURAT, METODOLOGJINË DHE ORGANIZIMIN E
KONTROLLIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT LIGJOR¹”, e ndryshuar

Kjo rregullore është hartuar në bazë të:

Nenit 38 dhe 39 të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i Rregullores

1. Kjo rregullore është përgatitur me qëllim për t’i mundësuar Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) hartimin dhe zbatimin një sistemi të monitorimit dhe të kontrollit të cilësisë së shërbimeve të auditimit në Shqipëri, për njësitë ekonomike me interes publik (NIP) dhe ato jo me interes publik (Jo-NIP), duke përfshirë monitorimin dhe kontrollin e sistemeve të brendshme të sigurimit të cilësisë së zbatuar nga audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit, si dhe kontrollet e angazhimeve individuale të shërbimeve të dhënies së sigurisë.²
2. Rregullorja përshkruan procesin dhe mënyrën e zhvillimit realizimit të procesit të kontrollit të cilësisë në kuadër të procesit të dhënies së sigurisë për cilësinë për auditimin ligjor, nga struktura mbështetëse. BMP miraton rregulla të hollësishme për delegimin dhe organizimin e kontrollit të cilësisë për auditimet e njëjësive jo me interes publik nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.³

¹ Ndryshuar

² Ndryshuar

³ Ndryshuar

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Sipas ligjit nr.10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, (më poshtë, cituar si “ligji i auditimit”) përgjegjësia për realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë së audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit është në ngarkim të BMP, me mundësinë e delegimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë së njësive jo me interes publik te organizata profesionale e audituesve ligjorë. Mundësia e delegimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë të auditimit të njësive jo me interes publik, do të lidhet ngushtë me kapacitetet që kjo organizatë profesionale do të ngrejë në mbështetje të përmbushjes së këtij roli, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe aktet e miratuara nga BMP për këtë qëllim⁴.
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është realizimi i mbikëqyrjes publike bazuar mbi politikat dhe procedurat të kontrollit të sigurimit të cilësisë të shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë për përmirësimin e cilësisë së praktikave të auditimit. Mangësitë/dobësitë e identifikuar gjatë kontrollit të sigurimit të cilësisë duhet të theksohen dhe kapacitetet e nevojshme duhet të krijohen për t’i eliminuar këto mangësi në kohë. Në rast të mangësive/dobësive sistematike me shtrirje të gjerë dhe të shpeshtë duhet të ndërmerren veprime të nevojshme nga organizata profesionale e audituesve ligjorë për adresimin e këtyre mangësive/dobësive në programet e tyre të kualifikimit të vijueshëm profesional⁵.
3. Kjo rregullore është e detyrueshme për zbatim nga subjektet e mëposhtme⁶:
 - a. Audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit që kryejnë auditime ligjore, shërbime të dhënies së sigurisë dhe shërbime të kontabilitetit në lidhje me zbatimin e kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës dhe kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator në Republikën e Shqipërisë;
 - b. Organizatën profesionale të audituesve ligjorë kur realizon kontrollin e sigurimit të cilësisë për auditimet ligjore të njësive ekonomike jo me interes publik;
 - c. Strukturën Mbështetëse të BMP’së.

KREU II

SISTEMI I KONTROLLIT TË CILËSISË DHE KUSHTET PËR KRYERJEN E AUDITIMIT LIGJOR PËR NJËSITË EKONOMIKE ME INTERES PUBLIK

Neni 3

Sistemi i garantimit të sigurimit të cilësisë

1. Sistemi i garantimit të sigurimit të cilësisë së auditimit përfshin 2 elementë:
 - Aktivitete të kontrollit të brendshëm të sigurimit të cilësisë organizuar nga audituesit

⁴ Ndryshuar

⁵ Ndryshuar

⁶ Ndryshuar

ligjorë/shoqëritë e auditimit, në përputhje me kërkesat përkatëse në standardin/et ndërkombëtar të kontrollit të cilësisë në zbatim. Proceset e kontrollit të sigurimit të cilësisë mund të realizohen prej burimeve që gjenden brenda të njejtës strukturë, kur kjo strukturë i ka kapacitetet e nevojshme dhe përmbush kërkesat e standardit/ve ndërkombëtar të kontrollit të cilësisë në zbatim dhe/ose mund të nën – kontraktohen nga struktura të tjera të cilat sigurojnë pajtueshmërinë me këto standarde. Audituesit ligjorë që realizojnë rishikimin e sigurimit të cilësisë duhet të kenë nivelin e përshtatshëm të kompetencave teknike dhe aftësive profesionale dhe përvojën përkatëse në auditimin ligjor dhe raportimin financiar të kombinuar me trajnime të posaçme për rishikimet e sigurimit të cilësisë⁷.

- Aktivitete të kontrollit të jashtëm të sigurimit të cilësisë organizuar dhe realizuar nga inspektorët e strukturës mbështetëse të BMP'së apo nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, në rast se aktivitete të tilla i delegohen nga BMP, përsa i përket pajtueshmërisë së sistemit të kontrollit të cilësisë së shoqërive të auditimit / audituesve ligjorë me kërkesat e përcaktuara në standardin/et ndërkombëtar të kontrollit të cilësisë në zbatim⁸.
2. Sistemi i brendshëm i kontrollit të cilësisë është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë e auditimit / audituesit ligjorë.⁹
 3. Shfuqizohet.¹⁰

Neni 3/1¹¹ **Tarifa e auditimit**

1. Tarifa e shërbimit të auditimit ligjor për njësitë ekonomike nuk duhet të jenë tarifa të kushtëzuara.
2. Në rastin kur një auditues ligjor/shoqëri auditimi dhe/ose shoqëri/persona fizikë që konsiderohen si shoqëri të lidhur me shoqërinë audituese/audituesin ligjor, ofron shërbime jo auditimi, si përcaktuar në nenin 3/2 (pika 1) të kësaj rregulloreje, për njësinë ekonomike të audituar, njësinë ekonomike të saj mëmë ose njësitë ekonomike të kontrolluara prej saj, për një periudhë financiare prej tre apo më shumë vite të njëpasnjëshme, shuma e tarifave për këto shërbime nuk duhet të jetë më e madhe se 70% e mesatares së tarifave të paguara, për tre vitet e njëpasnjëshme, për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike të audituar dhe kur është e zbatueshme për njësinë ekonomike të saj mëmë, njësinë (të) ekonomike të audituar/a dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara të grupit.
3. Në rastin kur totali i tarifës së paguar nga njësia ekonomike me interes publik çdo vit për tre vitet financiare të fundit të njëpasnjëshme, është më shumë se 15% i totalit të honorarëve/tarifave të faturuara për shërbimet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të atyre viteve të kryera nga audituesi ligjor / shoqëria e auditimit, apo sipas rastit audituesit të grupit, duhet t'i komunikohet komitetit të auditimit të njësisë ekonomike të audituar apo në mungesë personave të ngarkuar me qeverisjen, për rrethanat e kërcënimit të pavarësisë dhe masat e marra për zbutjen e këtyre kërcënimeve.

⁷ Ndryshuar

⁸ Ndryshuar

⁹ Ndryshuar

¹⁰ Shfuqizuar

¹¹ Ndryshuar

Neni 3/2¹²

Ndalimi i kryerjes së Shërbimeve jo-audituese

1. Një auditues ligjor / shoqëri auditimi i angazhuar në auditimin e njësisë ekonomike me interes publik, apo një anëtar i rrjetit të audituesit ligjor, të cilit i përket shoqëria e auditimit/audituesi ligjor si edhe/ose shoqëri/persona fizikë që konsiderohen si shoqëri e lidhur me shoqërinë audituese/audituesin ligjor, nuk do të kryejë për njësinë ekonomike të audituar, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, shërbime jo auditimi të ndaluara për:
 - a. Periudhën ndërmjet fillimit të periudhës së audituar dhe lëshimit të raportit të auditimit; dhe
 - b. Vitin financiar që pason menjëherë periudhën e specifikuar në pikën (a) më lart përsa i përket shërbimeve të përcaktuara në pikën (g) të shërbimeve jo auditimi të ndaluara.

Për qëllim të këtij neni shërbime jo auditimi të ndaluara janë:

(a) Shërbimet e konsulencës tatimore që lidhen me:

(i) përgatitjen e deklaratave tatimore;

(ii) llogaritjen e detyrimeve tatimore të listëpagesave;

(iii) detyrimet doganore;

(iv) identifikimi i subvencioneve dhe lehtësirave tatimore (fiskale), përveç rasteve kur ofrimi i këtij shërbimi nga audituesi ligjor/shoqëria e auditimit vjen si rrjedhojë e kërkesës ligjore;

(v) shërbime mbështetëse që lidhen me kontrollet tatimore nga autoritetet tatimore përveç rasteve kur ofrimi i këtij shërbimi nga audituesi ligjor/shoqëria e auditimit vjen si rrjedhojë e kërkesës ligjore;

(vi) llogaritja e tatimeve direkte dhe indirekte dhe tatimeve të shtyra;

(vii) ofrimi i shërbimit të konsulencës në lidhje me legjislacionin tatimor.

(b) Shërbime që kërkojnë pjesëmarrjen në çfarëdo pjese të drejtimit apo vendim marrjen të njësisë ekonomike të audituar;

(c) mbajtjen dhe përgatitjen e regjistrave të kontabilitetit dhe të pasqyrave financiare;

(d) Shërbime të llogaritjes së borderove të pagave;

(e) hartimi dhe zbatimi i procedurave të kontrollit të brendshëm apo të menaxhimit të riskut që lidhet me përgatitjen dhe/ose të kontrollit të raportimit financiar apo hartimin dhe zbatimin e sistemeve informatike të raportimit financiar

(f) Shërbime të vlerësimit, duke përfshirë këtu vlerësime që lidhen me shërbime të aktuarit dhe të proceseve gjyqësore;

(g) Shërbime ligjore që lidhen me:

(i) kryerjen e këshillimit ligjor të përgjithshëm;

(ii) negocimi në emër dhe për llogari të njësisë ekonomike të audituar; dhe

¹² Ndryshuar

(iii) shërbime të mbrojtjes në procese gjyqësore;

(h) shërbime që lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm të njësisë ekonomike të audituar;

(i) Shërbime që lidhen me financimin, strukturën e kapitalit dhe alokimin, investimet strategjike të njësisë ekonomike të audituar, përveç shërbimeve të dhënies së sigurisë që lidhen me pasqyrat financiare, si lëshimi i letrave të sigurisë në lidhje me pasqyrat financiare të lëshuara nga njësia ekonomike e audituar;

(j) promovimi, tregtimi apo nënshkrimi i kuotave/aksioneve të njësisë ekonomike të audituar;

(k) Shërbime të burimeve njerëzore që lidhen me:

(i) drejtimin në pozicione që ushtrojnë ndikim të rëndësishëm për përgatitjen e të dhënave të kontabilitetit apo raportimit financiar të cilat janë subjekt i auditimit ligjor, kur këto shërbime përfshijnë: - kërkimin për kandidatë në këto pozicione; ose – kryerja e kontrollit të referencave të kandidatëve për këto pozicione.

(ii) strukturimi i funksioneve organizative; dhe

(iii) kontrollin e kostove.

2. Lejohet ofrimi i shërbimeve jo auditimi, të përcaktuara në nënparagrafin e shërbimeve jo auditimi të ndaluara, me referencë në pikat (a) (i), (a) (iv) deri (a) (vii) dhe (f), në rastin kur audituesi ligjor/shoqëria e auditimit plotëson njëherësh kushtet e mëposhtme (a) këto shërbime nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë apo kanë një efekt jo material në mënyrë të veçantë apo së bashku në pasqyrat financiare të audituara; (b) vlera e efektit që kanë në pasqyrat financiare të audituara është dokumentuar dhe argumentuar në mënyrë të qartë në raportin shtesë për komitetin e auditimit apo në mungesë të tij në raportin për personat e ngarkuar me qeverisjen; dhe (c) audituesi ligjor/shoqëria e auditimit është në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës.

Neni 3/3¹³

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, gjatë ushtrimit të auditimit, ka përgjegjësinë dhe detyrimin e zhdëmtimit të pasojave financiare, që vijnë drejtpërdrejt nga gabimi apo faji i tij në punë. Pa iu shmangur kësaj përgjegjësie, audituesi ligjor apo shoqëria audituese, nga njëra anë dhe klienti i tyre, nga ana tjetër, mund të bien dakord për kufizimin e kësaj përgjegjësie, deri në një shumë të paracaktuar, në letrën e tyre të angazhimit ose në policën e sigurimit për mbulimin e përgjegjësiwe profesionale që vijnë drejtpërdrejt nga gabimi apo faji i audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit gjatë ofrimit të shërbimit të auditimit ligjor.

Neni 3/4¹⁴

Ruajtja e të dhënave

1. Audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit do të ruajnë dokumentacionin që lidhet më shërbimet e

¹³ Ndryshuar

¹⁴ Ndryshuar

realizuara prej tyre për një periudhë prej 10 vitesh nga viti pasues i krijimit të tyre.

2. Sistemet e arkivimit dhe mënyrat e ruajtjes së të dhënave duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse të standardit/eve ndërkombëtarë të kontrollit të cilësisë në zbatim, kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi dhe vendimeve të BMP'së në zbatim të tyre.

Neni 3/5¹⁵

Monitorimi i tregut

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike do të realizojë monitorimin e zhvillimit të tregut për shërbimin e auditimit ligjor dhe në veçanti do të vlerësojë bazuar në informacionin në dispozicion, si në vijim:
(a) rreziqet që vijnë nga identifikimi i vazhdueshëm i mangësive të cilësisë auditimit nga një auditues ligjor/shoqëri auditimit, duke përfshirë edhe mangësitë sistematike në rrjetin në të cilën bën pjesë shoqëria e auditimit, të cilat mund të çojnë në ndërprerjen e aktivitetit të shoqërisë së auditimit/audituesit ligjor dhe të shërbimeve të auditimit ligjor në një sektor specifik ose ndërmjet sektorëve, akumulimi i mëtejshëm të rrezikut të mangësive të auditimit; (b) nivelin e përqëndrimit të tregut, përfshirë sektorë specifikë; (c) domosdoshmërinë për marrjen e masave për adresimin e rrezikut të përmendur në pikën (a) të këtij neni.
2. Aktiviteti i kryer për qëllime të këtij neni do të jetë pjesë e raportit vjetor të BMP'së.

Neni 4

Kontrolli i sigurimit të cilësisë

1. Kontrolli i sigurimit të cilësisë për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit të angazhuar në auditimin e njësive me interes publik është periodik. Ky proces realizohet të paktën 1 herë në çdo tre vjet, bazuar në analizën e riskut.¹⁶
2. Kontrollin e sigurimit të cilësisë për audituesit ligjorë apo shoqëritë e auditimit, të angazhuar vetëm për njësitë jo me interes publik, është periodik. Ky proces realizohet të paktën 1 herë në çdo gjashtë vjet, bazuar në analizën e riskut.¹⁷
3. Për audituesit ligjorë me më pak se 5 vite eksperiencë në ushtrimin e profesionit, kontrolli i sigurimit të cilësisë bëhet çdo 2 vjet, deri sa të arrihet niveli i duhur i eksperiencës, bazuar në analizën e riskut¹⁸.
4. Në bazë të analizës së riskut, realizuar në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, BMP miraton audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit që duhet t'i nënshtrohen kontrollit të përvitshëm¹⁹.

Neni 5

Kontroll i plotë dhe i kufizuar

1. Kontrolli i plotë përfshin:
 - a. Kontrollin e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë së shoqërisë;

¹⁵ Ndryshuar

¹⁶ Ndryshuar

¹⁷ Ndryshuar

¹⁸ Ndryshuar

¹⁹ Ndryshuar

- b. Kontrollin e angazhimeve të auditimit.

Kontrolli i plotë bëhet në rastet kur kontrolli i cilësisë realizohet për herë të parë, si dhe në rastet kur kontrollet e mëparshme kanë evidentuar gjetje të rëndësishme. Në çdo rast, çdo auditues ligjor/shoqëri auditimi duhet të jetë subjekt i kontrollit të plotë brenda periudhës të përcaktuar në këtë rregullore.

2. Kontrolli i kufizuar (i pjesshëm) bëhet në rastet kur vlerësohet se është e nevojshme kryerja e një kontrolli më të thelluar mbi një çështje specifike në nivel të një audituesi ligjor/shoqërie auditimi apo në nivel të një industrie specifike. Çështjet mbi të cilët realizohet kontrolli i kufizuar mund të jenë të lidhura me: (i) një apo më shumë elementë të sistemit të kontrollit të cilësisë; (ii) zbatimin e një standardi të caktuar të auditimit; (iii) vlerësimin e pajtueshmërsë me kuadrin ligjor dhe rregullator; (iv) çështje të lidhura me parandalimin dhe pastrimin e parave, (v) dhe çështje të tjera të lidhura me auditimin.²⁰
3. Shfuqizohet.²¹

Neni 5/1²²

Mënyrat e realizimit të kontrollit të cilësisë

1. Kontrolli i sigurimit të cilësisë që organizohet nga BMP mund të realizohet në mënyrat e mëposhtme:
 - a. Kontroll me vizitë në vendin ku ushtron aktivitetin audituesi ligjor/ shoqëria e auditimit;
 - b. Kontroll nga zyra;
 - c. Kontroll i kombinuar me vizitë në vendin ku ushtron aktivitetin audituesi ligjor / shoqëria e auditimit dhe nga zyra;
2. Në çdo rast, pavarësisht tipologjisë së kontrollit i plotë apo i kufizuar, mënyra e realizimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë vendoset nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 6

Objekti i kontrollit të sigurimit të cilësisë

1. Objekti i kontrollit për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit të angazhuar pranë njësiteve ekonomike me interes publik përfshin:
 - a. Kontroll të sistemit të kontrollit të sigurimit të cilësisë;
 - b. Kontroll të cilësisë së angazhimeve të përzgjedhura të auditimit ligjor / shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë dhe shërbimeve të tjera të lidhura, në pajtim me fushëveprimin e kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës dhe standardit/eve ndërkombëtarë të kontrollit të cilësisë në zbatim.²³
2. Kontrolli, në varësi të tipologjisë i plotë apo i kufizuar, e shtrin fushëveprimin e tij mbi: (i) vlerësimin e sistemit të kontrollit të sigurimit të cilësisë së shoqërive të auditimit/audituesit ligjor;

²⁰ Ndryshuar

²¹ Shfuqizuar

²² Ndryshuar

²³ Ndryshuar

- (ii) cilësinë e dokumentacionit të angazhimit të auditimit; (iii) përputhshmërinë me standardet e zbatueshme të auditimit; (iv) përputhshmërinë me kërkesat përkatëse të etikës dhe pavarësisë; (v) cilësinë dhe sasinë e burimeve të angazhuar, përfshirë këtu pajtueshmërinë me kërkesat e edukimit të vijueshëm profesional; (vi) tarifat e shërbimit të auditimit; (vii) përputhshmërinë me ligjin 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar; (viii) çështje të lidhura me parandalimin dhe pastrimin e parave; (ix) çështje të tjera të lidhura me auditimin, raportimit financiar / zbatimin e standardeve të kontabilitetit, etj.²⁴
3. Gjithashtu, mund të ndodhë që çështje të ndryshme të rëndësishme mund të sinjalizohen te BMP nëpërmjet burimeve të jashtme, të ndryshme nga procedurat normale të kontrollit. Këto burime, bazuar në rregulloren nr. 4, datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”, e ndryshuar të BMP, mund të përfshijnë²⁵:
- Sinjalizime që ka mangësi materiale gjatë ekzekutimit të auditimit ligjor;
 - Informacione nga investitorët, audituesit, palët e tjera të interesuara dhe agjensi rregullatore;
 - Njoftime publike

Neni 7* (shfuqizohet) ²⁶

KREU III KONTROLLI I CILËSISË PËR AUDITIMET E NJËSIVE EKONOMIKE ME INTERES PUBLIK

Neni 8 Njësitë me interes publik

- Ligji për auditimin ligjor përcakton se, njësi me interes publik quhen:
 - të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
 - bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
 - shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
 - shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Angazhimet e auditimit të njësive ekonomike me interes publik janë objekt i kontrollit të brendshëm të cilësisë nga ana audituesit ligjor/shoqërive të auditimit. Shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë duhet të hartojnë kritere për të përcaktuar se cilat angazhime për njësitë ekonomike me interes publik duhet t'i nënshtrohen kontrollit të brendshëm të cilësisë përgjatë procesit të auditimit si dhe kritere për të përcaktuar se cilat angazhime për njësitë ekonomike me interes publik duhet t'i nënshtrohen kontrollit të cilësisë (inspektimit) si pjesë e procesit të

²⁴ Ndryshuar

²⁵ Ndryshuar

²⁶ Shfuqizuar

brendshëm të monitorimit periodik, në zbatim të kërkesave përkatëse të standardit/eve ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë në zbatim²⁷.

3. Shoqëritë e auditimit/ audituesit ligjorë duhet të raportojnë brenda datës 20 Janar të çdo viti të dhënat mbi angazhimet e auditimit të realizuara të njësive ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik dhe angazhimeve / shërbimeve të tjera të realizuara sipas specifikave të (Aneksit 1 – Modeli i miratuar i Deklarimit të Angazhimeve për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit). Ky model, në rast ndryshimi është objekt i miratimit nga BMP²⁸.

Neni 9

Procesi i përzgjedhjes

1. Njësitë ekonomike me interes publik të audituara duhet të renditen çdo vit sipas nivelit të riskut, të vlerësuar bazuar në analizën e vlerësimit të riskut (sipas tabelës 1 dhe tabelës 2).
- 1/1. Drejtori Ekzekutiv, me propozim të inspektorëve të strukturës mbështetëse të BMP'së, përcakton çdo vit faktorët riskut si dhe vlerat referuese për çdo faktor risku²⁹.
2. Bazuar në këtë renditje, procesi i përvitshëm i përzgjedhjes së angazhimeve të auditimit të njësive ekonomike me interes publik për sigurimin e cilësisë kryhet sipas kësaj radhe:
 - a. Përzgjedhja e angazhimeve të auditimit mbi bazën e periudhës së kontrollit.
 - b. Përzgjedhja e angazhimeve të auditimit, të cilat kërkojnë kontrolle shtesë për shkak të një treguesi risku specifik të lartë, pavarësisht periudhës së kontrollit.

²⁷ Ndryshuar

²⁸ Ndryshuar

²⁹ Ndryshuar

Tabela 1: Vlerësimi i riskut për njësitë ekonomike me interes publik të audituara³⁰

Vlerësimi i riskut							
Faktorët e riskut			Vlerësimi i nivelit të riskut			Ref	
Njësitë ekonomike me interes publik të audituara	Industria	Banka	ulët	mesëm	lartë		
		Institucione jo banka të licencuara nga Banka Shqipërisë					
		Shoqëri Financiare të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare					
		Shoqëri prodhimi					
		Shoqëri tregtimi					
		Shoqëri shërbimi					
		Të tjera					
	Struktura e NIP	Të listuara (Po/Jo)	ulët	mesëm	lartë		
		Degë e shoqërisë së huaj					
		Pjesëmarrja në treg (vogël, mesëm, madh)					
		Forma ligjore (SHPK, SHA)					
		Pronësia (pronari kryesor/pjesëmarrja/ jo-rezidentë)					
Lloji i opinionit (sipas historikut)	I pakualifikuar	ulët	mesëm	lartë			
	I kualifikuar						
	Mohim i opinionit						
	Negativ						
Probleme Auditimi nga rishikimi i fundit i BMP (të detajuara)		ulët	mesëm	lartë			
		ulët	mesëm	lartë			
Probleme Kontabiliteti nga rishikimi i fundit i BMP (të detajuara)		ulët	mesëm	lartë			
Periudha e përzgjedhjes për kontroll ³¹		ulët	mesëm	lartë			

³⁰ Faktorët e riskut në tabelat 1 dhe 2 shërbejnë si referencë e përgjithshme për përcaktimin dhe vlerësimin e faktorëve vjetorë të riskut.

³¹ Ndryshuar

Vlerësimi i riskut						
Faktorët e riskut			Vlerësimi i nivelit të riskut			Ref
	Probleme të përputhshmëri nga rishikimi i fundit i BMP (të detajuara)		ulët	mesëm	lartë	
	Të tjerë tregues risku (publikime negative në media, raportimet prej KKK, Propozime nga proceset e investigimit, Raportime e indicie të tjera) ³²		ulët	mesëm	lartë	

³² Ndryshuar

Tabela 2: Vlerësimi i riskut për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit

Vlerësimi i riskut						
Faktorët e riskut			Vlerësimi i nivelit të riskut			Ref
Audituesi Ligjor/Shoqëria e Auditimit	Struktura	Pjesë e një rrjeti (po/jo)	ulët	mesëm	lartë	
		Numri i partnerëve të auditimit				
		Numri i stafit të auditimit				
		Numri i angazhimeve të auditimit të njësive me interes publik				
		Numri i orëve të auditimeve të njësive me interes publik				
		Tarifa mesatare e angazhimeve të auditimit të njësive me interes publik				
		Numri i angazhimeve të auditimit të njësive jo me interes publik				
		Numri i orëve të auditimeve të njësive jo me interes publik				
		Tarifa mesatare e angazhimeve të auditimit të njësive jo me interes publik				
		Vlerësimi i mëparshëm i BMP'së (nëse ka pasur)	ulët	mesëm	lartë	
Sistemi i brendshëm i kontrollit të cilësisë (sipas historikut)	Periudha e përzgjedhjes për kontroll ³³	ulët	mesëm	lartë		
	Pa mangësi					
	Mangësi të evidentuara (detaje)					
	Përputhshmëri me standardet e përgjithshme: 1. Përgjegjësia e Drejtimit për cilësinë 2. Kërkesa të etikës 3. Pranim/vijimësi të angazhimeve të auditimit 4. Monitorimi 5. Performanca e angazhimit të auditimit 6. Burimet njerëzore					

³³ Ndryshuar

KREU IV
KONTROLLI I CILËSISË PËR AUDITIMET E NJËSIVE EKONOMIKE JO ME
INTERES PUBLIK

Neni 10
Kontrolli i sigurimit të cilësisë

1. Kontrolli i sistemit të cilësisë përfshin të gjithë audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit, të cilët auditojnë njësi ekonomike jo me interes publik, i cili parashikohet të realizohet të paktën 1 herë në çdo gjashtë vjet. Gjithashtu, bazuar në faktorët e riskut si dhe nisur edhe nga burimet e informacionit, BMP mund të identifikojë angazhime specifike auditimi të njësive jo me interes publik, të cilat kërkojnë kontroll më shpesh.

Ndërsa për audituesit ligjorë me eksperiencë më pak se 5 vite në ushtrimin e profesionit, kontrolli i sigurimit të cilësisë bëhet çdo 2 vite, deri sa të arrihet niveli i duhur i eksperiencës.

2. Objekti i kontroleve të auditimeve të njësive ekonomike jo me interes publik përfshin sistemin e kontrollit të cilësisë në nivel audituesi ligjorë/shoqërie auditimi dhe në nivel angazhimi auditimi. BMP mund t'i delegojë organizatës profesionale të audituesve ligjorë³⁴, organizimin dhe realizimin e kontrollit të sistemit të cilësisë të audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit, të cilët auditojnë njësitë ekonomike jo me interes publik.
 3. Për llojin dhe mënyrat e realizimit të kontrollit për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit që kryejnë auditime ligjore të njësive ekonomike jo me interes publik do të zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje dhe aktet e miratuara nga BMP për këtë qëllim³⁵.
- 3/1 Objekti i kontrollit për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit të angazhuar si pranë njësive ekonomike me jo me interes publik përfshin:
- a. Kontroll të sistemit të kontrollit të sigurimit të cilësisë;
 - b. Kontroll të cilësisë së angazhimeve të përzgjedhura të auditimit / shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë / procedurave të dakordësuara etj, në pajtim me fushëveprimin e standardit/eve ndërkombëtarë të kontrollit të cilësisë në zbatim. ³⁶
- 3/3 Kontrolli, në varësi të tipologjisë i plotë apo i kufizuar, e shtrin fushëveprimin e tij mbi: (i) vlerësimin e sistemit të kontrollit të sigurimit të cilësisë së shoqërive të auditimit/praktikuesit të vetëm; (ii) cilësinë e dokumentacionit të angazhimit të auditimit; (iii) përputhshmërinë me standardet e zbatueshme të auditimit; (iv) përputhshmërinë me kërkesat përkatëse të etikës dhe pavarësisë; (v) cilësinë dhe sasinë e burimeve të angazhuar, përfshirë këtu pajtueshmërinë me kërkesat e edukimit të vijueshëm profesional; (vi) tarifat e shërbimit të auditimit; (vii) përputhshmërinë me ligjin 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar; (viii) çështje të lidhura me parandalimin dhe pastrimin e parave; (ix) çështje të tjera të lidhura me auditimin, raportimit financiar / zbatimin e standardeve të kontabilitetit, etj³⁷.

³⁴ Ndryshuar

³⁵ Ndryshuar

³⁶ Ndryshuar

³⁷ Ndryshuar

3/4 Në rastet kur kontrolli i audituesve ligjorë të cilët auditojnë njësi ekonomike jo me interes publik do të jetë kontroll i kufizuar duhet të përfshijë të paktën tre prej çështjeve të mëposhtme të auditimit:

- Vlerësimi i përgjithshëm i firmës/audituesit ligjor për elementët e zbatueshëm të standardit/ve të kontrollit të cilësisë në fuqi.
- Pajtueshmëria me kërkesat e kuadrit ligjorë dhe rregullator
- Pranimit/vazhdimi i angazhimeve të auditimit
- Edukimi i vijueshëm profesional
- Arkivimi
- Vijimësia
- Materialiteti
- Raportimi³⁸

Neni 11³⁹

Procesi vjetor i kontrollit të cilësisë
Shfuqizohet

Neni 12⁴⁰

Përcaktimi i inspektorëve
Shfuqizohet

Neni 13

Përzgjedhja e audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit

1. Kontrolli për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit që kanë ndërmarrë angazhime auditimi të njëjësive jo me interes publik kryhet të paktën një herë në çdo gjashtë vjet. Prioritet i kushtohet audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit që paraqesin riskun më të madh bazuar në vlerësimin e riskut të bërë, sipas këtyre kriterëve (sipas tabelës 3 më poshtë):
 - Struktura dhe madhësia e audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit;
 - Numri dhe kompleksiteti i angazhimeve të auditimit;
 - Rezultatet e kontrollit të cilësisë të bëra në të kaluarën dhe shkalla e realizimit të veprimeve korrigjuese të kërkuara.
2. Kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit duhet të marrin në konsideratë edhe informacionin shtesë që vjen nga raportet vjetore të veprimtarisë së audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit. Në çdo rast, çdo auditues ligjor/shoqëri auditimi, që kanë audituar vetëm njësi ekonomike jo me interes publik⁴¹, duhet të kontrollohet të paktën 1 (një) herë në çdo gjashtë vjet. Gjithashtu, bazuar në faktorët e riskut si dhe nisur edhe nga burimet e informacionit mund të identifikohen angazhime specifike auditimi të audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit të njëjësive jo me interes publik, të cilat kërkojnë kontroll më shpesh. Shoqëritë e auditimit/ audituesit ligjorë duhet të raportojnë brenda datës 20 Janar të çdo viti të

³⁸ Ndryshuar

³⁹ Shfuqizuar

⁴⁰ Shfuqizuar

⁴¹ Ndryshuar

dhënat mbi angazhimet e auditimit të realizuara të njërive ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik dhe angazhimeve / shërbimeve të tjera të realizuara sipas specifikave të (Aneksit 1 – Modeli i miratuar i Deklarimit të Angazhimeve për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit). Ky model, në rast ndryshimi është objekt i miratimit nga BMP.⁴²

Tabela 3: Vlerësimi i riskut për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit⁴³

Vlerësimi i riskut						
Faktorët e riskut			Vlerësimi i nivelit të riskut			Ref
Auditues ligjor/Shoqëri auditimi	Struktura	Pjesë e rrjetit (po/jo)	ulët	mesëm	lartë	
		Numri i partnerëve të auditimit				
		Numri i stafit të auditimit				
		Numri i menaxherëve të auditimit				
		Numri i angazhimeve				
		Numri i orëve të angazhimeve të auditimeve (buxhetuar)				
		Numri i orëve të angazhimeve të auditimeve (faktike)				
		Tarifat e angazhimeve të auditimit				
	Sistemi i brendshëm i kontrollit të cilësisë (sipas historikut)	Mangësi të evidentuara (Po/Jo)	ulët	mesëm	lartë	
		Vlerësime të mëparshme të BMP'së	ulët	mesëm	lartë	
Periudha e përzgjedhjes për kontroll ⁴⁴						
	Përputhshmëri me standardet e përgjithshme	ulët	mesëm	lartë		
	1. Përgjegjësia e Drejtimit për cilësinë					
	2. Kërkesa të etikës					
	3. Pranim/vijimësi të angazhimeve të auditimit					
	4. Burimet njerëzore					
	5. Performanca e angazhimit të auditimit					
	6. Monitorimi					

⁴² Ndryshuar

⁴³ Faktorët e riskut në tabelat 3 dhe 4 shërbejnë si referencë e përgjithshme për përcaktimin dhe vlerësimin e faktorëve të riskut.

⁴⁴ Ndryshuar

Neni 14
Përzgjedhja e angazhimeve të auditimit

Përzgjedhja e angazhimeve të auditimit është e bazuar te risku për t'i dhënë prioritet atyre auditimeve që çdo vit paraqesin riskun më të lartë, bazuar në faktorët e riskut (shiko tabelën 4 më poshtë), që varen nga:

- Industria;
- Të dhënat financiare: aktivet, kapitali, të ardhurat, fitimi i vitit;
- Lloji i opinionit mbi auditimin;
- Çështje të rëndësishme të fushës së kontabilitetit;
- Koherencë në orët dhe tarifat e auditimit.

Tabela 4: Vlerësimi i riskut për njësitë ekonomike jo me interes publik të audituara

Vlerësimi i riskut						
Faktorët e riskut			Vlerësim i nivelit të riskut			Ref
Njësitë ekonomike jo me interes publik të audituara	Industria	Shoqëri prodhimi	ulët	mesëm	lartë	
		Shoqëri tregtare				
		Shoqëri shërbimi				
		Të tjera (specifiko)				
	Opinionit i auditimit (sipas historikut)	I pa kualifikuar	ulët	mesëm	lartë	
		I kualifikuar				
		Mohim i opinionit				
		Negativ				
	Probleme të auditimit (detaje)		ulët	mesëm	lartë	
			ulët	mesëm	lartë	
Probleme të kontabilitetit (detaje)		ulët	mesëm	lartë		
		ulët	mesëm	lartë		
Probleme përputhshmërie (detaje)		ulët	mesëm	lartë		
Të tjerë tregues risku (periudha e përzgjedhjes për kontroll, publikime)		ulët	mesëm	lartë		

Vlerësimi i riskut						
Faktorët e riskut			Vlerësim i nivelit të riskut			Ref
	negative në media, raportimet prej KKK, Propozime të ardhura nga proceset e investigimit, Raportime e indicie të tjera)					

Kërkesat e kreut IV do të zbatohen edhe nga organizata profesionale e audituesve ligjorë në rastin e delegimit, me vendim të Bordit të Mbikqërjes Publike, të kontrollit të sigurimit të cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik.

KREU V⁴⁵
**PROCEDURAT E KONTROLLIT TË CILËSISË DHE ADMINISTRIMI I PROCESIT
TË KONTROLLIT TË CILËSISË**

Neni 14/1⁴⁶
Procesi vjetor i kontrollit të cilësisë

Procesi i kontrollit të përvitshëm të cilësisë përbëhet nga këto hapa:

- a) Përcaktimi i inspektorëve;
- b) Përzgjedhja e audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit që do të kontrollohen;
- c) Identifikimi i qëllimit të kontrollit

Neni 14/2⁴⁷
Përcaktimi i inspektorëve

1. Përgjegjësia e kontrollit të sistemit të cilësisë së auditimeve ligjore është në ngarkim të BMP, me mundësinë që kontrolli i sistemit të cilësisë së auditimit të njërive jo me interes publik t'i delegohet organizatës profesionale të audituesve ligjorë.
2. Kontrolli i sigurimit të cilësisë realizohet nga inspektorët e strukturës mbështetëse të BMP'së, sipas planit të punës, të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratuar nga Kryetari i BMP. Bordi mund të asistohet nga ekspertë të angazhuar për të kryer kontrole cilësie specifike, në rastet kur:
 - a) numri i punonjësve të strukturës mbështetëse, që mbulojnë çështjet e dhënies së sigurisë për cilësinë është i pamjaftueshëm;
 - b) kur kjo konsiderohet thelbësore për kryerjen, në mënyrën e duhur, të kontrollit të cilësisë. Ekspertët që angazhohen duhet të plotësojnë kërkesat e pikës 5 të përcaktuara në nenin 4 të ligjit 10091/ 2009, për auditimin, i ndryshuar.
3. Në kuadër të mundësisë së delegimit të kontrollit të sistemit të cilësisë së auditimeve të njërive jo

⁴⁵ Ndryshuar

⁴⁶ Ndryshuar

⁴⁷ Ndryshuar

me interes publik, organizata profesionale e audituesve ligjorë duhet që të angazhojë inspektorët, përmes një procedure e cila siguron që:

- a) Inspektorët kanë kapacitete të mjaftueshme, aftësi dhe eksperiencë në punë,
- b) Inspektorët duhet të veprojnë në përputhje me parimet e objektivitetit dhe konfidencialitetit sipas kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës së profesionit.
- c) Inspektorët nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Kjo procedurë është subjekt mbikëqyrjeje nga BMP.

4. Inspektorët e angazhuar nga IEKA, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të kenë jo më pak se 10 vjet përvojë pune në fushën e auditimit ligjor e të raportimit financiar, kombinuar me trajnime specifike për dhënien e sigurisë së cilësisë;
 - b) të mos ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor dhe të mos jenë të punësuar apo të angazhuar me një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;
 - c) të mos kenë konflikt interesi ndërmjet tyre dhe me audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit. Këta punonjës, përpara nisjes së procesit të sigurimit të cilësisë, plotësojnë një deklaratë me shkrim, ku deklarojnë se nuk janë në konflikt interesi me audituesin ligjor dhe/ose shoqërinë e auditimit, objekt të kontrollit të cilësisë.
5. Në rastet kur inspektori ka qenë partner, i punësuar, apo i lidhur me një auditues ligjor apo shoqëri auditimi, atëherë ai nuk mund të kryejë kontroll të sistemit të cilësisë për këtë auditues ligjor ose shoqëri auditimi derisa të kenë kaluar, të paktën, tre vjet që nga momenti që ky inspektor ka pushuar së qeni partner, i punësuar, apo i lidhur me audituesin ligjor apo shoqërinë e auditimit.
6. Gjatë përcaktimit të inspektorëve të kontrollit të sistemit të cilësisë për secilin angazhim, organizata profesionale e audituesve ligjorë duhet të sigurojë që nuk ka konflikt interesi midis inspektorëve dhe audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit që janë subjekt i kontrollit, midis inspektorëve dhe organeve drejtuese të IEKA. Shkarkimi i inspektorëve të kontrollit të cilësisë të angazhuar nga IEKA do të kryhet me miratimin paraprak të BMP'së bazuar në evidencat e paraqitura lidhur me shkeljet që kanë çuar në shkarkimin e inspektorit/ve.
7. Pavarësia dhe aftësitë e inspektorëve duhet të jenë të dokumentuara.
8. Në rastet e delegimit të kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë së auditimeve të njëjësive jo me interes publik nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, kriteret, afatet dhe procedurat e delegimit do të përcaktohen me vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Neni 15

Fazat e kontrollit

1. Procesi i kontrollit është i ndarë në 3 faza të veçanta si më poshtë vijon:
 - Faza 1 – Përgatitja e kontrollit
 - Faza 2 – Kryerja e kontrollit
 - Faza 3 – Përfundimi i kontrollit dhe raportimi
2. Të gjitha hapat e procesit janë të detajuara në listë-kontrollin e procesit të inspektimit të audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit (Formulari A), e cila përmbledh hapat operativë që duhet të ndërmerren për të planifikuar, realizuar dhe përfunduar kontrollin.

Neni 16

Përgatitja për Kontroll

Përgatitja për kontroll kalon nëpër hapat si më poshtë:

a) *Identifikimi i audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit që do kontrollohet:*

Përzgjedhja e audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit subjekt kontrolli, do të realizohet sipas proceseve të përcaktuara në këtë rregullore. Lista e audituesve ligjorë/shoqërisë së auditimit të përzgjedhura i delegohet strukturës mbështetëse për zbatim.

b) *Kontakti me audituesin ligjor/shoqërinë e auditimit;*

Njoftimi për kontroll bëhet në formë shkresore, e cila përfshin programin e kontrollit, periudhën që mbulon kontrolli, listën e dokumenteve që duhet të kërkohen paraprakisht për të mundësuar përgatitjen e inspektorëve për kontroll. Në vijim të shqyrtimit të informacionit të paraqitur përcaktohen dhe njoftohen datat e vizitës në terren dhe afatet përkatëse⁴⁸. Partnerët dhe personeli kryesor duhet të jenë të gatshëm për kryerjen e intervistave. Merret në konsideratë që personeli që do të intervistohet të përzgjidhet përpara, në mënyrë që të jetë i gatshëm gjatë kontrollit.

b/1 Komunikimi me subjektin realizohet në formë shkresore dhe / ose elektronike në adresat e zyrës dhe të postës elektronike të publikuara në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit⁴⁹.

c) *Mbledhja dhe analiza e informacionit të kërkuar paraprakisht;*

Sigurohen dhe kontrollohen kopjet e dokumenteve të audituesit/shoqërisë, si më poshtë:

- Manualet e përgjithshme profesionale në zbatim, të auditimit, të kontrollit të cilësisë, të etikës dhe dokumente të tjera të brendshme në nivel të praktikës po ashtu edhe në nivel të rrjetit (kur është e aplikueshme); Kopje të këtyre manualeve duhet të vihen në dispozicion të inspektorëve të BMP'së, në formë elektronike dhe/ose shkresore në mënyrë të pa kufizuar⁵⁰;
- Dokumenta që certifikojnë marrëdhënien me rrjetin, përgjegjësinë e firmës anëtare dhe rrjetit në lidhje me kontrollin e cilësisë (mund të jenë në formën e politikave/procedurave apo manualeve globale), nëse është e shoqëria është pjesë e rrjetit apo ka përdorimin e të njëjtit emër tregtar ose të një pjese të rëndësishme të burimeve profesionale⁵¹;
- Raporte të kontrollit të organizatave profesionale, të autoriteteve rregullatore, të rrjetit të audituesit ligjor, kur është pjesë e rrjetit;
- Programin e monitorimit të kontrollit të brendshëm të cilësisë, përfshirë planin e kontrollit, listën e plotë të auditimeve të kontrolluara, si dhe udhëzimet për rishikuesit;
- Kopje të raporteve më të fundit të përfunduara të kontrollit të cilësisë të brendshëm, duke identifikuar gjetjet si dhe komunikimet e bëra për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna për mangësitë e evidentuara në këto raporte;
- Listën e klientëve për shërbimet e auditimit dhe jo auditimit;

⁴⁸ Ndryshuar

⁴⁹ Ndryshuar

⁵⁰ Ndryshuar

⁵¹ Ndryshuar

- Plotësimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit;
- Çështje të lidhura me parandalimin dhe pastrimin e parave në perputhje me kuadrin rregullator.
- Të tjera.

Informacionet e siguruar për qëllime të procesit të kontrollit të cilësisë janë të mbrojtura nga aktet rregullatore në fuqi, në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit.

ç) *Përgatitja e një plani të kontrollit, duke përfshirë edhe afatet kohore.*

Bazuar në informacionin më sipër, përgatitet një plan pune për kontrollin, ku përcaktohet edhe koha që nevojitet për realizimin e kontrollit në zyrat e subjektit.⁵²

Neni 17

Kryerja e kontrollit

Procesi i kontrollit pranë subjektit realizohet nëpërmjet këtyre hapave:

a) *Takimi fillestar*

Takimi fillestar ka qëllim prezantues dhe realizohet me personelin kryesor të audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit. Inspektorët në këtë takim bëjnë prezantimin e qëllimit të inspektimit, kohëzgjatjen e parashikuar të punës pranë subjektit, konfirmojnë marrjen (ose jo) të informacionit të kërkuar, konfirmojnë mjetet në dispozicion për kryerjen e këtij inspektimi (sallë, akses në sisteme dhe databaza etj).

Gjatë kësaj faze zhvillohen diskutime mbi politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë, veçanërisht mbi zbatimin e programit të monitorimit të kontrollit të brendshëm të cilësisë, përfshirë rezultatet nga monitorimet dhe kontrollet e kryera së fundmi si dhe diskutohet plani i vitit në vijim.

Takimi i parë realizohet në prani të personit përgjegjës për drejtimin dhe për kontrollin e brendshëm të cilësisë, duke bërë prezantimin e shoqërisë dhe paraqitjen e planit të kontrollit.

b) *Kontrulli i sistemit të brendshëm kontrollit të cilësisë së audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit;*

Gjatë kësaj faze zhvillohen diskutime të detajuara mbi mangësitë e gjetura në raportet e mëparshme të kontrollit (nga organizata profesionale ose autoriteti rregullator) dhe për mënyrën sesi janë adresuar këto probleme.

Në këtë fazë, inspektorët trajtojnë të gjithë elementët e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë, si më poshtë:

- Përgjegjësitë e drejtimin për cilësinë brenda shoqërisë.
- Kërkesat e rëndësishme mbi etikën.
- Pranimi dhe vazhdimësia e angazhimeve dhe marrëdhënieve me klientët.
- Burimet njerëzore.
- Kryerja e angazhimit.
- Monitorimi.

Elementë të kontrollit janë gjithashtu rregulloret dhe udhëzimet e brendshme të audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit të cilat mbajnë parasysh kërkesat ligjore për parandalimin dhe

⁵² Ndryshuar

pastrimin e parave si dhe rreziqet që mund të lindin nga klientë dhe aktivitete tregtare.

Udhëzimet në lidhje me këtë fazë paraqiten në formularët për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë.⁵³ Për të parë përshtatshmërinë e programit të monitorimit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit duhet të përdoren udhëzimet e përfshira në formularin për vlerësimin e programit të monitorimit të kontrollit të brendshëm të cilësisë (Formulari B.1 & Formulari B.2⁵⁴).

c) *Kontrolli i angazhimeve të përzgjedhura të auditimit;*

Në fazën e kontrollit të angazhimeve të auditimit të përzgjedhura, vlerësohet zbatimi i metodologjisë së audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit mbi auditimin, si dhe nëse auditimi është realizuar në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit. Rishikohet kontrolli i bërë bazuar në programin e monitorimit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë dhe/ose kryhen kontrole të drejtpërdrejta të angazhimeve të tjera.

Udhëzimet për këtë fazë paraqiten në formularin e kontroleve të angazhimeve individuale të auditimit (Formulari C). Për qëllime të realizimit të kontrollit të cilësisë pranë shoqërisë së auditimit/audituesit ligjorë, inspektorët e përcaktuar për kontroll mund të kërkojnë të disponojë një kopje të dosjes së plotë të angazhimit të auditimit, në formë elektronike dhe/ose shkresore⁵⁵.

ç) *Diskutimi i rezultateve*

Rezultatet e kontroleve të angazhimeve të rishikuara dhe /ose të kontroleve të drejtpërdrejta të kryera, diskutohen me ndihmën e partnerit/grupit të angazhimit, për të sqaruar fakte dhe siguruar përgjigje të shpejtë.⁵⁶

Bazuar në procedurat e realizuara, të cilat përfshijnë vëzhgimin, hetimin, ekzaminimin e dokumentacionit, konfirmohet që elementë të rëndësishëm të standardeve ndërkombëtare të auditimit, përfshirë dhe standardet mbi etikën, janë duke u zbatuar. Gjithashtu, përcaktohen fushat ku shoqëria nuk plotëson kërkesat e standardeve ndërkombëtare ose kërkesat e Standardit/eve Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë në zbatim⁵⁷.

d) Takimet dhe diskutimet e realizuara mund të dokumentohen në formë të regjistruar në pajisjen e regjistrimit të BMP'së me miratimin e shkruar nga audituesi ligjor/shoqërisë së auditimit subjekt kontrolli, për qëllime trajnimi dhe të kontrollit të brendshëm të cilësisë⁵⁸.

Neni 17/1⁵⁹

Shkaqet e ndërprerjes së kontrollit

1. Procesi i kontrollit të sigurimit të cilësisë që realizohet nga BMP mund të ndërpritet në rastet kur:
 - a. Inspektorët e kontrollit identifikojnë rrethana të përcaktuara në aktet rregullatore të miratuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
 - b. Audituesi ligjor/ shoqëria e auditimit refuzon, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk

⁵³ Ndryshuar

⁵⁴ Ndryshuar

⁵⁵ Ndryshuar

⁵⁶ Ndryshuar

⁵⁷ Ndryshuar

⁵⁸ Ndryshuar

⁵⁹ Ndryshuar

siguron informacionet për realizimin e qëllimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë nga BMP.

2. Pezullimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarisë apo fshirja e përkohshme nga regjistri publik i audituesit ligjor / shoqëria e auditimit nuk përbën shkak për mosfillimin apo ndërprerjen e realizimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë nga BMP.
3. Të gjitha rastet kur audituesi ligjor/shoqëria e auditimit, e përzgjedhur sipas dispozitave të kësaj rregulloreje për realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë, refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit, do t'i nënshtrohen dispozitave të Rregullores nr.4 datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat e marrjen e masave disiplinore”, e ndryshuar.

Neni 18

Përfundimi i kontrollit dhe raportimi

1. Në përfundim të realizimit të kontrollit, realizohet një mbledhje me personelin përgjegjës përfaqësues të shoqërisë së auditimit/audituesin ligjor ku diskutohet rreth procesit të inspektimit, çështjet kryesore të trajtuara dhe nënvizohen disa prej gjetjeve kryesore, si dhe çështjet ende në trajtim⁶⁰.
2. Ekipi i inspektimit në mbyllje të vizitës në terren, harton draft raportin e kontrollit të cilësisë sipas Formularit D për Raportin e Kontrollit dhe Shtojcës D.1 për Planin e Veprimit. Gjatë kësaj faze parashikohen komunikime të mëtejshme me shoqërinë e auditimit/audituesin ligjor në lidhje me çështjet e pambyllura në funksion të finalizimit të draft raportit⁶¹.
3. Draft raporti i kontrollit i dërgohet audituesit ligjor/ shoqërisë së auditimit të kontrolluar i/e cili/a brenda 2 javëve nga marrja e tij duhet të paraqesë planin e veprimit si pjesë përbërëse e draft raportit të kontrollit për sigurimin e cilësisë, për adresimin e mangësive të identifikuara gjatë kontrollit. Plani i veprimit i paraqitur nga audituesi ligjor/shoqëria e auditimit, do të jetë objekt i diskutimit në takimin përmbyllës ndërmjet ekipit të inspektimit dhe drejtuesit/stafin përgjegjës për kontrollin e cilësisë të shoqërisë së auditimit/audituesit ligjor të kontrolluar⁶².
- 3/1. Në vijim të diskutimit në takimin përmbyllës, audituesi ligjor/shoqëria e auditimit ri dërgon planin e veprimit, të plotësuar sipas rastit në vijim të takimit përmbyllës, si pjesë përbërëse e draft raportit të kontrollit të cilësisë, brenda afatit të përcaktuar nga inspektorët e kontrollit⁶³.
- 3/2. Në rast se audituesi ligjor/shoqëria e auditimit për shkaqe të paarsyeshme nuk paraqet, brenda afatit të përcaktuar, planin e veprimit, për adresimin e mangësive të identifikuara gjatë procesit të kontrollit, do të jetë subjekt i investigimit dhe masave disiplinore sipas dispozitave të Rregullores nr.4 datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat e marrjen e masave disiplinore”, e ndryshuar.⁶⁴
4. Raporti i përfundimtar kontrollit duhet të përfshijë:

⁶⁰ Ndryshuar

⁶¹ Ndryshuar

⁶² Ndryshuar

⁶³ Ndryshuar

⁶⁴ Ndryshuar

- a) Mangësitë e konstatuara gjatë kontrollit, të klasifikuara në këto kategori:
- Përputhshmëria me Kodin e Etikës për profesionin sipas IESBA;
 - Përputhshmëria me standardin/et ndërkombëtarë të kontrollit të cilësisë në zbatim⁶⁵;
 - Përputhshmëria me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, dhe
 - Përputhshmëria me kuadrin ligjor dhe rregullator relevant⁶⁶ në fuqi.
- b) Mangësitë e konstatuara nga kontrollet e mëparshme dhe akoma të pakorrigjuara nga shoqëria.
- c) Komentet e bëra nga shoqëria e auditimit/audituesi ligjor i kontrolluar në lidhje me mangësitë.
- ç) Planin e veprimit për të adresuar mangësitë, i cili duhet të ketë këto elementë:
- Identifikim të veprimit të nevojshëm të sugjeruar;
 - Caktim të përgjegjësive të një individ apo grup brenda shoqërisë;
 - Përcaktim i një afati të miratuar, por jo më shumë se 12 muaj nga data e raportit përfundimtar të kontrollit, nga audituesi ligjor/shoqëria e auditimit e kontrolluar dhe inspektori për korrigjimin e mangësive ose zbatimin e planit të veprimit.
- 4/1. Shkresa përcjellëse që shoqëron draft raportin e kontrollit të cilësisë dhe/ose raportin përfundimtar të kontrollit të cilësisë do të nënshkruhet nga Drejtori Ekzekutiv ose Kryetari i BMP'së. Në mungesë të tyre për shkaqe të arsyeshme apo për shkak të konfliktit të interesit shkresa përcjellëse do të nënshkruhet nga inspektori i lartë i kontrollit të cilësisë me më shumë eksperiencë në detyrë.⁶⁷
5. Raporti përfundimtar i kontrollit hartohet brenda 4 javëve nga marrja e planit të veprimit, sipas pikës 3.1 të këtij neni⁶⁸, të audituesit ligjor/shoqërisë audituese të kontrolluar dhe një kopje dërgohet brenda 2 javësh nga data e hartimit tek:
- Shfuqizuar⁶⁹
 - Audituesi ligjor/ Partneri/ partnerët e shoqërisë së kontrolluar;
 - Të tjerë në përputhje me ligjin.
- 5/1. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet kontrolluesit (ekipit të inspektimit) dhe subjektit të kontrolluar (shoqërisë së auditimit / audituesit ligjor), përsa i përket procedurave të ndjekura për procesin e kontrollit të cilësisë nga Inspektorët e BMP, çështja trajtohet nga Komisioni i Brendshëm i Kontrollit të Cilësisë, pasi audituesi ligjor i kontrolluar ka paraqitur formalisht qëndrimet e tij. Në rast se mosmarrëveshjet lidhen me procedurat e kontrollit të sigurimit të cilësisë të njësive ekonomike jo me interes publik të realizuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, këto mosmarrëveshje do të adresohen nga strukturat përkatëse të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.⁷⁰
- 5/2. a. Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton raportin përmbledhës të raporteve përfundimtare të

⁶⁵ Ndryshuar

⁶⁶ Ndryshuar

⁶⁷ Ndryshuar

⁶⁸ Ndryshuar

⁶⁹ Shfuqizuar

⁷⁰ Ndryshuar

kontrollit për sigurimin e cilësisë. Në raportin përmbledhës përcaktohet nota vlerësuese për çdo raport përfundimtar kontrolli për sigurimin e cilësisë.

b. Nota vlerësuese përcaktohet në bazë të kritereve të miratuara me Vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, për qëllime të brendshme të BMP, përveç rasteve kur ky informacion jepet si kërkesë e drejtpërdrejtë e kuadrit ligjor dhe rregullator.

c. Vendimi për vlerësimin me notë i njoftohet subjektit të kontrolluar në përputhje me mënyrat dhe afatet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

- 5/3. Raportet e kontrollit të sigurimit të cilësisë të realizuara nga inspektorët e BMP'së, duhet të paraqiten në raportin përmbledhës të kontrollit të cilësisë për inspektimet e realizuara. Organizata profesionale e audituesve ligjorë paraqiten në raportin përmbledhës të kontrollit të cilësisë, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, për rezultatet e sistemit të kontrollit të cilësisë për auditimet e njëjësive ekonomike që nuk janë me interes publik, kur delegohet nga BMP. Raportet miratohen nga BMP, e cila nga ana e saj duhet të përgatisë përmbledhjen e raportit vjetor me pikat e forta dhe të dobëta të cilësisë së auditimit, duke përfshirë konkluzionet, rekomandimet dhe planin e veprimit për periudhën në vijim. Rezultatet e përgjithshme të sistemit të kontrollit të cilësisë publikohen çdo vit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.⁷¹

Neni 18/1⁷² **Kontrollet pasuese**

1. Shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë të kontrolluara dhe plani i veprimit i paraqitur në raportin përfundimtar të kontrollit janë objekt i kontrolleve pasuese prej ekipit të inspektorëve të BMP-së.
2. Numri i kontrolleve pasuese dhe shpeshësia e tyre përcaktohen në varësi të shkeljeve dhe mangësive të identifikuara në raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë.
3. Shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë të kontrolluar duhet të dërgojnë pranë BMP, të paktën çdo 6 muaj informacion mbi statusin e zbatimit të hapave të ndërmarra për korrigjimin e situatës dhe adresimin e mangësive deri në korrigjimin e situatës ose deri në kontrollin e rradhës së cilësisë bazuar në analizën e rrezikut.
4. Në përfundim të kontrollit pasues, inspektorët e kontrollit të sigurimit të cilësisë hartojnë një raport mbi statusin faktik dhe efektivitetin e masave të ndërmarra nga shoqëria e auditimit/audituesi ligjor sipas planit të veprimit të përcaktuar në pikën 4, gërma ç të nenit 18 të kësaj rregullore. Në bazë të rezultatit të këtij raporti, BMP shqyrton dhe vendos mbi vlerësimin e bërë sipas pikës 5/2 gërma a e nenit 18 të kësaj rregullore, për subjektet në fjalë.
5. Pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni do të zbatohen në rastin e delegimit të realizimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik edhe nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.

KREU VI **DISPOZITA TË FUNDIT**

⁷¹ Ndryshuar

⁷² Ndryshuar

Neni 19
Dispozita të fundit dhe hyrja në fuqi

1. Formularët e mëposhtëm janë pjesë e metodologjisë së kontrollit të cilësisë:

Formulari A	Listë-kontrolli i procesit të inspektimit me audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit
Formulari A.1	Formati i shkresës për njoftimin e inspektimit të audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit.
Formulari B	Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë
Formulari B.1	Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë (<i>përt'u plotësuar nga audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit</i>)
Formulari B.2	Vlerësimi i programit të monitorimit të kontrollit të brendshëm të cilësisë (<i>për t'u plotësuar nga audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit</i>).
Formulari C	Listë-kontrolli kontrollit të angazhimeve individuale të auditimit
Formulari D	Raporti i kontrollit
Formulari D.1	Plani i veprimit
Formulari E	Pyetësori për personelin (<i>opsional</i>)
Aneksi 1:	Modeli i miratuar i Deklarimit të Angazhimeve për audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit
Aneksi 2:	Për formatin e raportimit nga organizatat profesionale
2. Çështjet që nuk janë të parashikuara në këtë rregullore rregullohen me vendim të veçantë të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
- 2/1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton me vendim të BMP'së, delegimin tek organizata profesionale e audituesve ligjorë për realizimin e kontrollit të cilësisë në vijim të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në vendim⁷³.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

KRYETAR
Dritan Fino

⁷³ Ndryshuar